

VENDIM
Nr. 20, datë 21.4.2016

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LEZHË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lezhë, me:

Drejtues ligjor: Zef Maçi

Drejtues teknik: Petrit Bardhi

2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Lezhë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Lezhë, njësitë administrative Shëngjin, Balldren.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare, deri në datën 2.7.2017.

Ky vendim hyn në datën 4.7.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi